



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 4, datë 28 .02. 2013

**PËR
“VENDOSJEN E MEMORIALIT PËR SIMBOLET E DIKTATURËS “POSTBLOK”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8/VII gërma “a”, nenit 10 pika 3/I, shkronja “ë” dhe nenit 32, gërma “m” të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), Këshilli Bashkiak i Tiranës, pasi mori në shqyrtim relacionin për vendosjen e “Memorialit për Simbolet e Diktaturës “Postblok”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Të miratojë vendosjen e “Memorialit për Simbolet e Diktaturës “Postblok””, në lulishten që ndodhet në kryqëzimin e Bulevardit “Dëshmorët e Kombit” me rrugën “Ismail Qemali”, përballë hotel “Rogner”, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit dhe Promovimit të Qytetit, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I
Niazi KOSOVRASTI**